



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0698

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr.2025/0698 si dhe ankesa e OE “FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, dhe vendimit për anulim të procedurës të “Komuna e Lipjanit”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me numër të prokurimit 613-25-4036-5-2-1, me 24/10/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat e OE “FLAMURI V” SH.P.K., me nr. 2025/0698, e datës 28/07/2025, dhe 2025/0764, e datës 11/08/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me numër të prokurimit 613-25-4036-5-2-1 me numër të prokurimit 613-25-4036-5-2-1, iniciuar nga AK “Komuna e Lipjanit”.

2. Vertetohet Njoftimi mbi Vendimin e AK të “Komuna e Lipjanit”, lidhur me aktivitetin e prokurimit Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë me numër të prokurimit 613-25-4036-5-2-1

3.Me qenë se ankesat e operatorit ekonomik ankues aprovohen si pjesërisht të bazuara, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 14.05.2025, “Komuna e Lipjanit” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me numër të prokurimit 613-25-4036-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës:

Llot 1- 138,000.00€Llot 2- 120,000.00 €.

B58 Njoftimi i parë mbi Vendimin - 11.07.2025.

Me 25.07.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 dhenie te kontratës per Lot 1 dhe per anulim per Lot 2.

Me 16.07.2025, OE “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 te Autoritetit Kontraktues. Me datë 30.07.2025 OE “FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 18.07.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilin ka aprovuar si pjesërisht te bazuar kërkesën e Operatorit Ekonomik nr 698/25. Dhe me datën 31.07.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilin ka refuzuar si te pa bazuar kerkesen peer Rishqyrtim te Operatorit Ekonomik ankues nr.764/25.

Me 28/07/2025, OE “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2025/0698 me datë 11/08/2025 OE “FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764 dhe ankesen me nr.2025/0764, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me nr te prokurimit 613-25-4036-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0698-0764/2025 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 janë parashtruar si në vijim:

Fillimisht duhet sqaruar që me datë 11.07.2025 AK e ka publikuar njoftimin mbi vendimin kundër të cilit ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 16.07.2025. Ndërsa me datë 18.07.2025 AK ka nxjerrë vendimin për miratimin e pjesshëm të kërkesës tonë për rishqyrtim. Në fund të këtij vendimi është vendosur këshilla juridike me përmbajtjen si vijon:

E drejta e ankesës në OSHP kundër vendimit të AK është e garantuar përmes nenit 108 dhe 109A të LPP ku përcaktohet se ankesa mund të dorëzohet vetëm brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas datës së njoftimit përkatësisht vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Përtej kësaj, vet AK e ka vendosur si këshillë juridike të drejtën e ankuesit që të parashtroj ankesë brenda 10 ditëve pas vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Në rastin konkret vendimi i AK është publikuar me datë 21.07.2025 përmes të cilit është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar kërkesa jonë për rishqyrtim. Natyrisht që ne nuk jemi të kënaqur me këtë vendim sepse AK është dashur që të miratoj kërkesën tonë si të bazuar në tërësi dhe jo vetëm pjesërisht. Për këtë arsye brenda afatit ligjor prej 10 ditëve jemi duke parashtruar ankesë në OSHP. Mirëpo për befasinë tonë, AK me datë 25.07.2025 ka publikuar sërish një B58 Njoftim mbi Vendimin e ri të AK (i cili në përmbajtje është i njëjtë sikurse B58 Njoftimi mbi Vendimin e datës 11.07.2025 të cilin ne e kemi goditur me kërkesë për rishqyrtim dhe tani me ankesë në OSHP). Kjo nënkupton që AK ende pa kaluar afati ligjor prej 10 ditëve “ka përfunduar” me rivlerësimin dhe ka publikuar vendimi i ri i cili në fakt është i njëjtë sikurse vendimi i kaluar.

Kjo jo vetëm që përbën shkelje flagrante të procedurës së prokurimit publik por edhe tendencë të hapur të AK për favorizimin e OE të cilin po dëshiron t’a shpallë si fitues duke i shkelur procedurat e prokurimit. Lidhur me këtë veprim të AK, kërkojmë që OSHP t’i shqiptoj një vërejtje ZPP dhe të kërkoj që të respektohen afatet procedurale sipas LPP në fuqi.

Përndryshe në kërkesën tonë për rishqyrtim, edhe pse është miratuar si pjesërisht e bazuar, në fakt AK nuk ka trajtuar fare pretendimet tona ankimore por vetëm i ka përshkruar pretendimet duke i vlerësuar ato në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare. Për këtë arsye ne jemi të detyruar që të përsërisim pretendimet tona ankimore me shpresën që Paneli Shqyrtues do t’i shqyrtoj të njëjtat në mënyrë objektive dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ju faleminderit paraprakisht për konsideratën.

LIDHUR ME LOT 2

Pretendimi nr. 1 - Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të anuluar aktivitetin e prokurimit në kuptim të nenit 62 të LPP pasi që të oferta e dorëzuar nga Flamuri V shpk është në tërësi e përgjegjshme dhe ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT pa asnjë përjashtim.

Në njoftimin mbi vendimin për lot 2 AI< ka njoftuar se ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si në vijim:

Komuna Lipjan anulon aktivitetin e prokurimit: Per arsye se nuk kemi asnjë operator ekonomik te pergjegjshem ne Llot 2.

Tutje në letrën standarde për si arsye për eliminimin e ofertës tonë si të papërgjegjshme ka shënuar si vijon:

ARSYETIM Kërkesa e DT të cilës i referohet arsyeja eliminuese është formuluar si në vijim:

Për pajisjen finisher ne kemi dorëzuar marrëveshjen e qirasë me qiradhënësin “Asfalt Group” shpk. Po ashtu kemi dorëzuar edhe faturën e blerjes së pajisjes. Përndryshe komisioni vlerësues ka pasur mundësi që të dal në terren dhe të verifikoj pajisjen në fjalë.

Sidoqoftë, kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që të dorëzohet ose DUD-i doganor apo Fatura e Blerjes. Në rastin konkret ne e kemi dorëzuar faturën e blerjes (nuk është kontestuese) dhe në këtë mënyrë e kemi përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit. Te kërkesa e DT e cituar më sipër është hijezuar pikërisht fjala lidhëse APO e cila nënkupton që ose Fatura ose DUD-i cilado prej tyre janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e DT. Tani në fazën e vlerësimit të ofertave AK nuk mund të ndryshoj kërkesat e DT dhe të kërkoj më shumë ose më ndryshe prej asaj që ka kërkuar fillimisht në DT.

LIDHUR ME LOT 1

Pretendimi nr. 2 - Tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur disa kërkesa të DT prandaj nuk është dashur që të rekomandohet për dhënie të kontratës por është dashur që të eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Deklaratat nën betim nuk janë plotësuar në rregull (ky është kusht administrativ për të cilin menjëherë duhet eliminuar OE si të papërgjegjshëm pa të drejtën as për të kërkuar sqarime shtesë). Fillimisht te OE Valdrini pozita e personit që ka nënshkruar deklaratën është deklaruar si pronar ndërsa në certifikatën e biznesit deklarohet si drejtor menaxhues. Mirëpo përtej këtij fakti, te asnjëra deklaratë nën betim të anëtarëve të GOE nuk janë cituar të dhënat lidhur me aktivitetin e prokurimit as titulli dhe as numri. Pra nuk dihet se për cilin aktivitet të prokurimit janë dorëzuar këto deklarata nën betim. Juridikisht dhe praktikisht këto deklarata janë të pavlefshme pasi që nuk i referohen konkretisht aktivitetit të prokurimit për të cilin është dorëzuar oferta.

Tutje, te vendimi për caktimin e menaxherit, drejtimi i menaxherit nuk është konstruktiv edhe pse në DT është kërkuar konstruktiv.

Tutje, te CV e gjeodetit nuk është e skanuar nga origjinali edhe pse në DT specifikisht kërkohet që CV të jetë e skanuar nga origjinali (për të shmangur mundësitë e manipulimit).

Tutje, plani dinamik nuk ofron absolutisht asnjë specifikim të aktiviteteve dhe si i tillë është i pavlefshëm pasi që nuk ofron asnjë pasqyrë specifike të punëve (në formën që është dorëzuar është njësoj sikurse të mos ishte dorëzuar fare).

Problemi më i madh te ky aktivitet i prokurimit është fakti që tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar makinerinë të cilën e ka marrë me qira nga Asfalt Group shpk. Të njëjtën makineri nga i njëjti qiradhënës e kemi prezantuar edhe nga në të njëjtin aktivitet të prokurimit. Megjithatë

ne jemi eliminuar pikërisht për shkak të makinerisë të Lot 2 ndërsa OE Valdrini është shpallur fitues. Kjo jo vetëm që është e palogjikshme por edhe juridikisht është gabim shumë i madh nga AK.

Pretendimi nr. 3 - Ofertuesi “Arching Group” shpk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur disa kërkesa të DT prandaj nuk është dashur të cilësohet si i pasuksesshëm por është dashur që të eliminohet si i përgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Nënshkrimi nuk është origjinal i pronarit - shihet qartë që nënshkrimi është marrë si screen shot (pra si foto) dhe është vendosur në dokument (pra nuk është e skanuar nga origjinali sikurse kërkohet me DT). Njësoj është vepruar edhe te deklarata nën betim dhe te lista e pajisjeve ku figuron vetëm titulli i lotit dhe jo numri i prokurimit. Kjo përbën shkelje dhe arsye eliminuese të ciliën nuk e ka evidentuar AK.

Kontratat e punonjësit Nuhi Nuhiu për lot 1 dhe lot 2 nuk janë të skanuara nga origjinali.

Po ashtu edhe kontratat për lot 1 dhe 2 nuk janë skanuar nga origjinali për punonjësit vijues:

Lot 21. Bardh Shillova 2. Korab Bajrami 3. Olti Byçi

Lot 11. Gani Ahmataj 2. Korab Bajrami 3. Olti Byçi

Tutje, as marrëveshja për makineri me Bislimi, Burimi, Arbëri NS dhe Bergeri nuk janë të skanuara nga origjinali dhe shihet qartësisht që nënshkrimi është i shtuar më pastaj përmes manovrave kompjuterike.

Tutje, Kamionat kiper me peshë bartëse min 8t të kërkuar 3 cope nuk janë me afat të regjistrimit në librezë. 2. Kamionat me Kran min 2 cope po ashtu nuk janë me afat të regjistrimit në librezë.

Në fund vlen të shtohet që pajtohem me pjesën ku AK ka eliminuar si të përgjegjshëm OE të tjerë mirëpo vetëm duhet theksuar që nuk janë prezantuar të gjitha arsyet për eliminimin e tyre në letrat përkatëse për eliminim.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së, Neni 62 i LPP-së. Nga sa u tha më sipër kërkojmë që AK të merr këtë: VENDIM të MIRATOHET si e bazuar në tërësi ankesa e OE “Flamuri V” Sh.P.K. ashtu që kthehet në rivlerësim aktiviteti i prokurimit me titull “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me nr. të prokurimit 613-25-4036-5-2-1.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 Aprovohet pjesërisht e bazuar, kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, e datës 16.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1 kundër Vendimit të AK ~së, të datës 11.07.2025, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Anulohet vendimi i AK për shpërblym me kontratë për Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1, dhe Anulohet vendimi i AK për per anulim të procedurës për Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

Operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, me 16.07.2025, ka parashtruar ankesë lidhur me vendimin për shpërblim me kontratë për Llot 1 dhe vendimin për anulim të procedurës për llot 2 të datës 11.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi i juaj ankimorë se oferta e juaj për Hot 2 që është në tërësi e përgjegjshme, nuk qëndron sepse të dëshmia 3 është cek ndër të tjera që: ...”të gjitha ato mjete që paraqiten me fatur të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor”.

Ne si Autoritet Kontraktues, konkretisht komisioni vlerësues nuk e kapasur obligim që të del në teren për verifikim por ju ka mjaftuar dokumentacioni i ofruar nga ju dhe nuk është ndryshuar asnjë kërkesë e Dosjes së tenderit siq e keni cek ju në kërkesën për rishqyrtim dhe nuk kemi kërkuar më shumë se që është kërkuar në FTD dhe DT.

Lidhur me pretendimin tjetër rreth deklaratës nën betim, ju informojmë se deklaratat nën betim të grupit të operatorëve ekonomik të propozuar për kontratë janë të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ju njoftojmë që OE i propozuar për kontratë ka këtë inxhinier me drejtim “Ndërtimtari dhe infrastrukturë specializimi Inxhinieri Strukturore dhe inxhinieria strukturore është e njëjta me konstruktiv dhe ndalet nga universiteti se si e specifikon, për këtë mund të konsultoheni edhe me universitetin përkatës për informata shtesë ju si OE, Inxhinieria strukturore apo konstruktiv ka të bëjë me degen e inxhinierisë civile dhe mirret me projektimin, analizen dhe ndërtimin e strukturave të ndryshme dhe objekteve tjera inxhinierike.

Lidhur me CV e gjeodetit, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi ne si AK kemi kërkuar që Stafin profesional të deshmohet me Diplome dhe CV, pra, nuk kemi cek që CV të skanohet nga origjinali apo kopja dhe nuk mund të kërkojmë nga operatorët ekonomik diçka që nuk e kemi kërkuar në dosjet e tenderit dhe njoftim për kontratë.

Ankesa e juaj rreth planit dinamik nuk qëndron pasi që në FTD dhe Dosjet e tenderit nuk e kemi kërkuar si kriter planin dinamik.

Rreth marrëveshjes me Asfalt Group nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë dhe nga ju, as ky pretendim nuk qëndron pasi që për llot 1 paisja “Finisher” nuk ka qenë kërkesë ndërsa llot 2 e kemi anuluar pikërisht për këtë paisje.

Të deklaratat nën betim të OE Arching group konkretisht nënshkrimet e pronarit, dhe nënshkrimet e punëtorëve të kontratave, për ne si AK janë të plotësuara sipas ligjit dhe nuk paraqesin ndonjë gabim.

Sa i përket pretendimit tuaj lidhur me kamionet ju njoftojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar. AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764 janë parashtruar si në vijim:

E drejta e ankesës në OSHP kundër vendimit të AK është e garantuar përmes nenit 108 dhe 109A të LPP ku përcaktohet se ankesa mund të dorëzohet vetëm brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas datës së njoftimit përkatësisht vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Përtej kësaj, vet AK e ka vendosur si këshillë juridike të drejtën e ankuesit që të parashtroj ankesë brenda 10 ditëve pas vendimit të AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim.

Në rastin konkret vendimi i AK është publikuar me datë 21.07.2025 përmes të cilit është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar kërkesa jonë për rishqyrtim. Natyrisht që ne nuk jemi të kënaqur me këtë vendim sepse AK është dashur që të miratoj kërkesën tonë si të bazuar në tërësi dhe jo vetëm pjesërisht. Për këtë arsye brenda afatit ligjor prej 10 ditëve jemi duke parashtruar në OSHP ankesën me shenjë OSHP:2025/0698 të dt.28.07.2025.

Mirëpo për befasinë tonë, AK me datë 25.07.2025 ka publikuar sërish një B58 Njoftim mbi Vendimin e ri të AK (i cili në përmbajtje është i njëjtë sikurse B58 Njoftimi mbi Vendimin e datës 11.07.2025 të cilin ne e kemi goditur me kërkesë për rishqyrtim por edhe me ankesë në OSHP). Kjo nënkupton që AK ende pa kaluar afati ligjor prej 10 ditëve “ka përfunduar” me rivlerësimin dhe ka publikuar vendimi i ri i cili në fakt është i njëjtë sikurse vendimi i kaluar.

Kjo jo vetëm që përbën shkelje flagrante të procedurës së prokurimit publik por edhe tendencë të hapur të AK për favorizimin e OE të cilin po dëshiron t’a shpallë si fitues duke i shkelur procedurat e prokurimit.

Përndryshe në kërkesën tonë për rishqyrtim, edhe pse është miratuar si pjesërisht e bazuar, në fakt AK nuk ka trajtuar fare pretendimet tona ankimore por vetëm formalisht i ka përshkruar pretendimet duke i vlerësuar ato në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare.

LIDHUR ME LOT 2

Pretendimi nr. 2 - Nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të anuluar aktivitetin e prokurimit në kuptim të nenit 62 të LPP pasi që të oferta e dorëzuar nga Flamuri V shpk është në tërësi e përgjegjshme dhe ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT pa asnjë përjashtim.

Në njoftimin mbi vendimin për lot 2 AK ka njoftuar se ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si në vijim:

Komuna Lipjan anulon1 aktivitetin e prokurimit; Per arsye se nuk kemi asnje operator ekonomik te pergjegjshem ne Lot 2.

Tutje në letrën standarde për si arsye për eliminimin e ofertës tonë si të përgjegjshme ka shënuar si vijon:

ARSYETIM

Për pajisjen finisher ne kemi dorëzuar marrëveshjen e qirasë me qiradhënësin “Asfalt Group” shpk. Po ashtu kemi dorëzuar edhe faturën e blerjes së pajisjes. Përndryshe komisioni vlerësues

ka pasur mundësi që të dal në terren dhe të verifikoj pajisjen në fjalë.

Sidoqoftë, kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që të dorëzohet ose DUD-i doganor apo Fatura e Blerjes. Në rastin konkret ne e kemi dorëzuar faturën e blerjes (nuk është kontestuese) dhe në këtë mënyrë e kemi përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit. Te kërkesa e DT e cituar më sipër është hijezuar pikërisht fjala lidhëse APO e cila nënkupton që ose Fatura ose DUD-i cilado prej tyre janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesën e DT.

Tani në fazën e vlerësimit të ofertave AK nuk mund të ndryshoj kërkesat e DT dhe të kërkoj më shumë ose më ndryshe prej asaj që ka kërkuar fillimisht në DT.

LIDHUR ME LOT 1

Pretendimi nr. 3 - Tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur disa kërkesa të DT prandaj nuk është dashur që të rekomandohet për dhënie të kontratës por është dashur që të eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Deklaratat nën betim nuk janë plotësuar në rregull (ky është kusht administrativ për të cilin menjëherë duhet eliminuar OE si të papërgjegjshëm pa të drejtën as për të kërkuar sqarime shtesë). Fillimisht te OE Valdrini pozita e personit që ka nënshkruar deklaratën është deklaruar si pronar ndërsa në certifikatën e biznesit deklarohet si drejtor menaxhues. Mirëpo përtej këtij fakti, te asnjëra deklaratë nën betim të anëtarëve të GOE nuk janë cituar të dhënat lidhur me aktivitetin e prokurimit as titulli dhe as numri. Pra nuk dihet se për cilin aktivitet të prokurimit janë dorëzuar këto deklarata nën betim. Juridikisht dhe praktikisht këto deklarata janë të pavlefshme pasi që nuk i referohen konkretisht aktivitetit të prokurimit për të cilin është dorëzuar oferta.

Tutje, te vendimi për caktimin e menaxherit, drejtimi i menaxherit nuk është konstruktiv edhe pse në DT është kërkuar konstruktiv.

Tutje, te CV e gjeodetit nuk është e skanuar nga origjinali edhe pse në DT specifikisht kërkohet që CV të jetë e skanuar nga origjinali (për të shmangur mundësitë e manipulimit).

Tutje, plani dinamik nuk ofron absolutisht asnjë specifikim të aktiviteteve dhe si i tillë është i pavlefshëm pasi që nuk ofron asnjë pasqyrë specifike të punëve (në formën që është dorëzuar është njësoj sikurse të mos ishte dorëzuar fare).

Problemi më i madh te ky aktivitet i prokurimit është fakti që tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar makinerinë të cilën e ka marrë me qira nga Asfalt Group shpk. Të njëjtën makineri nga i njëjti qiradhënës e kemi prezantuar edhe nga në të njëjtin aktivitet të prokurimit. Megjithatë ne jemi eliminuar pikërisht për shkak të makinerisë te Lot 2 ndërsa OE Valdrini është shpallur fitues. Kjo jo vetëm që është e palogjikshme por edhe juridikisht është gabim shumë i madh nga AK.

Pretendimi nr. 4 - Ofertuesi “Arching Group” shpk ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur disa kërkesa të DT prandaj nuk është dashur të cilësohet si i pasuksesshëm por është dashur që të eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet prokurimit.

Nënshkrimi nuk është origjinal i pronarit - shihet qartë që nënshkrimi është marrë si screen shot (pra si foto) dhe është vendosur në dokument (pra nuk është e skanuar nga origjinali sikurse kërkohet me DT). Njësoj është vepruar edhe te deklaratat nën betim dhe te lista e pajisjeve ku figuron vetëm titulli i lotit dhe jo numri i prokurimit. Kjo përbën shkelje dhe arsye eliminuese të cilën nuk e ka evidentuar AK.

Kontratat e punonjësit Nuhi Nuhiu për lot 1 dhe lot 2 nuk janë të skanuara nga origjinali.

Po ashtu edhe kontratat për lot 1 dhe 2 nuk janë skanuar nga origjinali për punonjësit vijues:

Lot 21. Bardh Shillova 2. Korab Bajrami

3. Olti Byçi

Lot 11. Gani Ahmataj 2. Korab Bajrami 3. Olti Byçi

Tutje, as marrëveshja për makineri me Bislimi, Burimi, Arbëri NS dhe Bergeri nuk janë të skanuara nga origjinali dhe shihet qartësisht që nënshkrimi është i shtuar më pastaj përmes manovrave kompjuterike.

Tutje, Kamionat kiper me peshë bartëse min 8t të kërkuar 3 cope nuk janë me afat të regjistrimit në librezë. 2. Kamionat me Kran min 2 cope po ashtu nuk janë me afat të regjistrimit në librezë.

Në fund vlen të shtohet që pajtohem me pjesën ku AK ka eliminuar si të papërgjegjshëm OE të tjerë mirëpo vetëm duhet theksuar që nuk janë prezantuar të gjitha arsyet për eliminimin e tyre në letrat përkatëse për eliminim.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “FLAMURI V” SH.P.K., m nr. 2025/764 pr konsideron se Autoriteti Kontraktues Neni 59 par. 4 i LPP Neni 62 i LPP. Nga sa u tha më sipër kërkojmë që Paneli Shqyrtues të merr këtë: VENDIM të MIRATOHET si e bazuar në tërësi ankesa e OE “Flamuri V” Sh.P.K. ashtu që ANULOHET njoftimi mbi vendimin B58 dhe pezullohet aktiviteti i prokurimit deri sa Paneli Shqyrtues në OSHP të vendos lidhur me ankesën me nr. 2025/0698 të dt. 28.07.2025. ANULOHET njoftimi mbi vendimin i dt. 16.07.2025 si dhe njoftimi mbi vendimin e dt. 25.07.2025 ashtu që kthehet në rivlerësim aktiviteti i prokurimit me titull “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me nr. të prokurimit 613-25-4036-5-2-1.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për OE “FLAMURI V” SH.P.K., m nr. 2025/764 Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e operatorit ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, e datës 30.07.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1 kundër Vendimit të AK -së, të datës 25.07.2025, të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Vertetohet vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1, dhe Vërtetohet vendimi i AK për anulim të procedurës për Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-2-1.

Operatori ekonomik Flamuri V SHPK Malishevë, me 30.07.2025, ka parashtruar ankesë lidhur me vendimin për shpërblim me kontratë për Llot 1 dhe vendimin për anulim të procedurës për Llot 2 të datës 25.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë”, me Nr. të Prok: 613-25-4036-5-

2-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 31.07.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lidhur me pretendimin tuaj për vendimin e AK se ka qene pjeserisht i bazuar e jo i bazuar ne teresi, ju informojme se ne si AK e kemi vleresuar dhe kemi marre vendime ne baze te ligjit ne fuqi, dhe lenda e njejt eshte kthyer ne rivlersim ku kemi kerkuar sqarime aty ku ne kemi vleresuar qe eshte e nevojshme dhe vendimi ka mbet i njejt sepse nuk ka pas nevoj te ndryshohet asgje, dhe ju si operatore ekonomik e keni mundesine qe te shfrytezohni te drejten tuaj ankimore kurdo qe e shihni te arsyeshme. Gjithashtu, ju informojme se ankesen tuaj e kemi trajtuar ne te gjitha pikat dhe ju kemi pergjigjur dhe nuk kemi pasur asnje pretendim per favorizime siq keni pretenduar ju.

Pretendimi i juaj ankimorë se oferta e juaj për llot 2 që është në tërësi e përgjegjshme, nuk qëndron sepse te dëshmia 3 është cek ndër të tjera që: ... ”të gjitha ato mjete qëparaqiten me fatur të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor”.

Ne si Autoritet Kontraktues, konkretisht komisioni vlerësues nuk e ka pasur obligim që të del në teren për verifikim por ju ka mjaftuar dokumentacioni i ofruar nga ju dhe nuk është ndryshuar asnjë kërkesë e Dosjes së tenderit siq e keni cek ju në kërkesen për rishqyrtim dhe nuk kemi kerkuar më shumë se që është kerkuar në FTD dheDT.

Lidhur me pretendimin tjetër rreth deklaratës nën betim, ju informojmë se deklaratat nën betim të grupit të operatoreve ekonomik të propozuar për kontratë janë të plotësuar sipas legjislacionit nëfuqi.

Sa i perket pretendimit tuaj lidhur me inxhinierin e ndertimtarise drejtimi konstruktiv, ju njoftojme qe OE i propozuar per kontrate ka kete inxhinier me drejtim “Ndertimtari dhe inftrastruktur specializimi Inxhinieri Strukturore dhe inxhinieria strukturore eshte e njejte me konstruktiv dhe nvaret nga univeristet se si e specifikon, per kete mund te konsultoheni edhe me universitetin perkates per info shtese ju si OE, Inxhinieria strukturore apo konstruktiv ka te beje me degen e inxhinierise civile dhe mirret me projektimin, analizen dhe ndertimin e strukturave te ndryshme dhe objekteve tjera inxhinierike.

Lidhur me CV e gjeodetit, edhe ky pretendim nuk qendron pasi ne si AK kemi kerkuar qe Stafi profesional te deshmohet me Diplome dhe CV, pra, nuk kemi cek qe cv te skanohet nga origjinali apo kopja dhe nuk mund te kerkojme nga operoret ekonomik diqka qe nuk e kemi kerkuar ne dosje te tenderit dhe njoftim per kontrate.

Ankesa e juaj rreth planit dinamik nuk qendron pasi qe ne FTD dhe Dosje te tenderit nuk e kemi kerkuar si kriterplanin dinamik.

Rreth marreveshjes me Asphalt Group nga operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate dhe nga ju, as ky pretendim nuk qendron pasi qe per llot 1 paisja “Finisher” nuk ka qene kerkese ndersa llot 2 e kemi anuluar pikerisht per kete paisje.

Te deklarata nen betim e OE Arching group konkretisht nenshkrimet e pronarit, dhe nenshkrimet e punetoreve te kontratat, per ne si AK jane te plotesuara sipas ligjit dhe nuk paraqesin ndonje gabim.

Sa i perket pretendimit tuaj lidhur me kamionet ju njoftojme qe ky pretendim tani eshte i pa bazuar pasiqe AK per kete arsye e ka kthyer lenden ne rivlersim dhe kemi kerkuar sqarime nga ky operator ekonomik dhe ne afatin e parapare ligjor eshte pergjigjur dhe e ka plotesuar kete pike.AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi shqyrtues i prokurimit me datë 01/08/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesave me nr. 0698/2025, me datën 12/08/2025 ka autorizuar ekspertin per ankesën me nr.0764/2025.

Lidhur me ankesën nr. 0698/2025 me datë 11/08/2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2025/0698 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserisht e bazuar per Lot 1 dhe Lot 2, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Lidhur me ankesën nr. 0764/2025 me datë 12/08/2025 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2025/0764 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjeserisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës per Lot 1 dhe njoftimi për anulim për Lot 2 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0698/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit te ekspertës shqyrtuese.

Raportin e ekspertizës me nr.0764/2025 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje me raportin e ekspertës shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës shqyrtuese, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0698 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtuar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues, ka anuluar aktivitetin e prokurimit

LOT 2 ne kundërshtim me LPP-në.

Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave AK-Komuna Lipjan, me datën 10.07.2025 e njofton OE ankues, me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

“Ne si AK, ju kemikerkuar sqarime përmes Letres standarde të datës :27.06.2025, ku kemi kërkuar që të na ofroni sqarime për paisjet: 1. Finisher dhe 2. Cilinder hekur-hekur. Ne përgjigjen tuaj ju na keni ofruar një fakturë të blerjes për finisher por nuk na keni ofruar dudin doganor”.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues për Lot 2, autoriteti kontraktues në dosje të tenderit, ka kërkuar:

Deshmia 3. Lista e paisjeve të nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjete që paraqiten me faturë të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me deshmite sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti të nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën për deshmie të pajisjeve të cituar më lart, filimisht vlerëson se AK në këtë rast ka krijuar hapesirë për interpretim të dyfishtë, sepse në pjesën e parë e përmend termin dudin doganor APO faturë të blerjes dhe në vazhdim kërkon që faturës t'i bashkangjitet edhe dudi doganor.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues lidhur me pajisjen finisher ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjes me një operatore ekonomik dhe faturën e blerjes së pajisjes. Eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues për Lot 2 ka ofruar deshmie të mjaftueshme lidhur me pronësinë e pajisjes.

Pretendimi nr. 1.OE ankues, në ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontratë për Lot 1 nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht pretendon se deklaratën nën betim e ka plotësuar drejtori menaxhues i cili nuk është pronar dhe njëherit pretendon se deklarata nën betim nuk i përmban të dhënat si: titulli i aktivitetit të prokurimit dhe numri i prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të deklaratës nën betim, sqaron se OE i rekomanduar e ka dorëzuar deklaratën nën betim të vulosur dhe nënshkruar nga personi kompetent, mirepo në deklarata nën betim ka përfshirë dhe nuk gjendet titulli i aktivitetit të prokurimit dhe numri i prokurimit. Pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë, për menaxher të projektit ka dorëzuar deshmie të inxhinierit të ndërtimtarisë – drejtimit inxhinieri strukturor, pra sipas OE ankues nuk i ka dorëzuar deshmie sipas kërkesës së DT-së, ku është kërkuar Inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktive. Eksperti shqyrtues sqaron se është i bazuar pretendimi i OE ankues sepse i rekomanduari për kontratë i ka dorëzuar deshmie të inxhinierit të ndërtimtarisë – drejtimit inxhinieri strukturor. Lidhur me këtë çështje ekspert shqyrtues sqaron se në vendimin e kërkesës për rishqyrtim AK ka deklaruar se është drejtim ekuivalent dhe sipas deklaramentit të AK-së është drejtim i njëjtë. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja nuk ka ofruar asnjë provë se

drejtimet e lartpermendura jane ekuivalente.

Pretendimi nr. 3OE ankues, pretendon se CV-ja e inxhinierit te gjeodezise, nuk eshte e skanuar nga origjinali, eksperti shqyrtues, vlereson se nuk qendron ky pretendim i OE ankues sepse deshmit per inxhinierin ne fjale jane sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Pretendimi nr. 4OE ankues, pretendon se i rekomanduari per kontrate nuk ka ofruar nje plan dinamik te qart dhe nuk ofruar asnje pasqyre te puneve, eksepti shqyrtues, sqaron se nuk qendron ky pretendim per faktin se AK ne dosje te tenderit nuk ka kerkuar plan dinamik dhe eliminimi per nje kere se cila nuk ekziston eshte ne kundërshtim me dipozitat e nenin 56.3 te LPP-se.

Pretendimi nr. 5OE ne ankesen e tij ka pretendime edhe lidhur me oferten tjeter OE Arching Group, ku pretendon se ne deklaraten nen betim dhe ne listen e pajisjeve nuk e ka shenuar numrin e prokurimit. Eksperti shqyrtues, vlereson se dy deshmit per te cilat pretendon OE ankues nuk e kan te shenuar numrin e prokurimit, megjithate fakti qe OE Arching Group e ka shenuar titullin e aktivitetit te prokurimit, identifikohet aktiviteti i prokurimit. Prandaj, ky pretendim nuk eshte i bazuar.

Pretendimi nr. 6OE ankues pretendon se deshmit e stafit profesional nuk jane te skanuara nga origjinali poashtu pretendon se marrevshjet per shfrytezimin e pajisjeve nuk jane te skanuara nga origjinali. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qendron pretendimi i OE ankues lidhur me deshmit e stafit dhe marrevshjeve per pajisjet sepse deshmit jane sipas kerkeseve te dosjes se tenderit.

Pretendimi nr. 7Sa i perket pretendimit te OE ankues lidhur me afatin e regjistrimit te automjeteve, ku OE ankues pretendon se dy pajisje nuk kan afat te regjistrimit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK konform nenit 72 ka kerkuar sqarime nga OE arching Group, i cili e ka sqaruar dhe i njeiti ka deshmuar se e ploteson kerkesen e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues ““FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764 Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0764 ka vlerësuar se:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues, ka anuluar aktivitetin e prokurimit LOT 2 ne kundërshtim me LPP-në.

Pas përfundimit te vlerësimit te ofertave AK-Komuna Lipjan, e njofton OE ankues, me letrën standarde të tenderuesit te eliminuar.

“Ne si AK, ju kemikerkuar sqarime përmes Letres standade te datës :27.06.2025, ku kemi kërkuar qe te na ofroni sqarime per paisjet: 1. Finisher dhe 2. Cilinder hekur-hekur. Ne pergjigjen tuaj ju na keni ofruar nje faktur te blerjes per finisher por nuk na keni ofruar dudin doganor”.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankues per Lot 2, autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit, ka kërkuar:

Dëshmia 3. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjete që paraqiten me faturë të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dudin doganor. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën për dëshmi të pajisjeve të cituar më lart, filimisht vlerëson se AK në këtë rast ka krijuar hapësirë për interpretim të dyfishtë, sepse në pjesën e parë e përmend termin dudin doganor APO fature të blerjes dhe në vazhdim kërkon që faturës t'i bashkëngjitet edhe dudi doganor.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues lidhur me pajisjen finisher ka dorëzuar marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjes me një operatore ekonomik dhe faturën e blerjes së pajisjes. Eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues për Lot 2 ka ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me pronësinë e pajisjes.

Pretendimi nr. 1. OE ankues, në ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontratë për Lot 1 nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht pretendon se deklaratën nën betim e ka plotësuar drejtori menaxhues i cili nuk është pronar dhe njeherit pretendon se deklarata nën betim nuk i përmban të dhënat si: titulli i aktivitetit të prokurimit dhe numri i prokurimit.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të deklaratës nën betim, sqaron se OE i rekomanduar e ka dorëzuar deklaratën nën betim të vulosur dhe nënshkruar nga personi kompetent, mirëpo në deklaratën nën betim ka ndërhyrë dhe nuk gjendet titulli i aktivitetit të prokurimit dhe numri i prokurimit. Pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 2. OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë, për menaxher të projektit ka dorëzuar dëshmitë e inxhinierit të ndërtimtarisë – drejtimit inxhinieri strukturor, pra sipas OE ankues nuk i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së DT-së, ku është kërkuar Inxhinier i ndërtimtarisë – konstruktive. Eksperti shqyrtues sqaron se është i bazuar pretendimi i OE ankues sepse i rekomanduari për kontratë i ka dorëzuar dëshmitë e inxhinierit të ndërtimtarisë – drejtimit inxhinieri strukturor. Lidhur me këtë çështje eksperti shqyrtues sqaron se në vendimin e kërkesës për rishqyrtim AK ka deklaruar se është drejtim ekuivalent dhe sipas deklaramentit të AK-së është drejtim i njëjtë. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja nuk ka ofruar asnjë provë se drejtimet e lartpërmendura janë ekuivalente.

Pretendimi nr. 3. OE ankues, pretendon se CV-ja e inxhinierit të gjeodezisë, nuk është e skanuar nga origjinali, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues sepse dëshmitë për inxhinierin në fjalë janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Pretendimi nr. 4. OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk ka ofruar një plan dinamik të qartë dhe nuk ofruar asnjë pasqyrë të punëve, eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron ky pretendim për faktin se AK në dosje të tenderit nuk ka kërkuar plan dinamik dhe eliminimi për një kërkesë e cila nuk ekziston është në kundërshtim me depozitat e nenin 56.3 të LPP-së.

Pretendimi nr. 5OE ne ankesën e tij ka pretendime edhe lidhur me ofertën tjetër OE Arching Group, ku pretendon se ne deklaratën nen betim dhe ne listën e pajisjeve nuk e ka shënuar numrin e prokurimit. Eksperti shqyrtues, vlerëson se dy dëshmitë për te cilat pretendon OE ankues nuk e kanë te shënuar numrin e prokurimit, megjithatë fakti qe OE Arching Group e ka shënuar titullin e aktivitetit te prokurimit, identifikohet aktiviteti i prokurimit. Prandaj, ky pretendim nuk është i bazuar.

Pretendimi nr. 6OE ankues pretendon se dëshmitë e stafit profesional nuk janë te skanuara nga origjinali poashtu pretendon se marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve nuk janë te skanuara nga origjinali. Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me dëshmitë e stafit dhe marrëveshjeve për pajisjet sepse dëshmitë janë sipas kërkesave te dosjes se tenderit.

Pretendimi nr. 7Sa i përket pretendimit te OE ankues lidhur me afatin e regjistrimit te automjeteve, ku OE ankues pretendon se dy pajisje nuk kanë afat te regjistrimit, eksperti shqyrtues, sqaron se AK konform nenit 72 ka kërkuar sqarime nga OE arching Group, i cili e ka sqaruar dhe i njëjti ka dëshmuar se e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrat.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave lidhur me Lot 1 ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit sa i perket Lot 1, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale me kete rast PSH besimin ja fal ekspertit shqyrtues vetem pjeserisht , keshtu PSH do lëshohet vetëm në pretendimin lidhur me deklaratën nen betim i cili konsiderohet se eshte pretendim percaktues sa i

perkete Lot 1 , keshtu PSH vlereson se OE i rekomanduar per kontrate etim, ka dorezuar deklaraten nen betim te vulosur dhe nenshkuar nga personi kompetente, mirepo ne deklaraten nen betim siç nuk eshte specifikuar titulli i aktivitetit te prokurimit , PSH kete pretendim ankimor e vlereson si pjeserisht te bazuar duke marre parasysh faktin se edhe nga ekspertit eshte vertetuar se e njejta eshte nenshkuar nga personi kompetent dhe po ashtu eshte dorezuar bashklidhur ofrtes keshtu PSH vendos qe Vendimi i AK duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim lidhur me Lot 1, për arsyet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”, atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje (në pafundësi) dhe nisur nga fakti se është në diskrecion të AK vënia në zbatim edhe e neni 59.4 sa i përket devijimeve të vogla, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104.4 të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave lidhur me Lot 2 nr.2025/764

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik lidhur me Lot 2 , aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndersa Vendimi i AK të mbetet ne fuqi keshtu duke vleresuar se AK edhe pas sqarimeve shtese kundrejt OE ankues nuk ka arritur te deshmoj se i njejti i ploteson kushtet e parapara sipas kerkesave te vendosura ne DT.

Keshtu PSH lidhur me pretendimet se AK nuk ka zbatuar dispozitat ligjore per anulimin e procedures PSH vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i njëjtë i cili i prinë edhe nje vendimi paraprak që janë nxjerrë nga komisione të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesionale dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të

ofertës”. Atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë, si dhe zhvillimi i kësaj procedure. Njëherit është edhe në diskrecion të AK zbatimi i neneve 59 dhe 60 të LPP, ku për AK nuk ka ndonjë argumenti bindës se OE i ankues mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “FLAMURI V” SH.P.K., ankesa nr .2025/0698 aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me nr. të prokurimit: 613-25-4036-5-2-1, të mbetet në fuqi. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke vertetuar vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “FLAMURI V” SH.P.K., m nr.2025/764 aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Llot 1 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Kraishtë, Llot 2 Ndërtimi i trotuareve në fshatin Baicë” me nr. të prokurimit: 613-25-4036-5-2-1, të mbetet në fuqi. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke vertetuar vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - FLAMURI V SH.P.K., FLAMURI V SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: